



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.339/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj- kryesues, Kimete Kicaj dhe Hidajete Gashi Alaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Nedime Belegu, kandidate për kryetare në Komunën e Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Epoka e Hyjneshës, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsisë në listën bartëse, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 27.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZL.Anr.339/2025, e datës 24.10.2025, e parashtruar nga Nedime Belegu, kandidate për kryetare në Komunën e Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Epoka e Hyjneshës, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsisë në listën bartëse, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 24.10.2025, ka pranuar ankesën ZL.Anr.339/2025, nga Nedime Belegu, kandidate për kryetare në Komunën e Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Epoka e Hyjneshës, paraqitur ndaj KQZ-së, me të cilën pretendon se në zgjedhjet komunale ka kandiduar për kryetare të Komunës së Prishtinës dhe bartës e listës për asamble komunale, mandej ka kuptuar se dikush nga KQZ e ka larguar nga lista bartëse dhe e ka emëruar Kimete Ahmeti si bartëse të listës, pa u konsultuar me parashtruesen e ankesës.

Ka bashkangjitur fotografi të bisedave telefonike në Viber.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 25.10.2025, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), kanë deklaruar se ZRCKFSP i ka krijuar useri-in për qasje në platformën për iniciativën “Epoka e Hyjneshës” në Prishtinë, për të bërë aplikimin për certifikimin për zgjedhjet lokale, të datës 2 tetor 2025. Të dhënat janë dërguar nga ZRCKFSP, me kredenciale për kyçe në sistem. Personi i autorizuar i iniciativës “Epoka e Hyjneshës”, ishte Nedime Belegu, të dhënat e kandidatëve dhe dokumentet të cilat kërkohen për certifikim janë ngarkuar përmes sistemit online nga personi i autorizuar i subjektit. ZRCKFSP vetëm i shqyrton aplikimin dhe dërgon të dhënat e kandidateve për verifikim nga KGJK. Zyra nuk ndërhyr dhe nuk plotëson të dhënat e kandidatëve e as numrat e tyre rendor.

Tutje, kanë shutuar se në bazë të nenit 9, paragrafi 4 të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2024 për Certifikimin e Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre parashihet procedura e aplikimit

dhe shqyrtimit të kërkesave për certifikim si dhe procedurat tjera të parapara me rregulloren e lartcekur. Bazuar në nenin 29 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili thekson se subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së një njoftim me shkrim me të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje jo më vonë se dy ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për zgjedhje, të përcaktuar sipas nenit 25 paragrafi 1 të këtij ligji. Duke marrë parasysh se shorti për renditjen e subjekteve politike në fletëvotim, për zgjedhjet lokale të datës 12 tetor 2025, është mbajtur me datën 04.09.2025, andaj në kuptim të nenit të lartcekur dhe datës së tërheqjes së shortit, konsiderojmë se ankesa e palës ankuese është e pasafatshme.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

- *Ankesa është e pasafatshme.*

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Nedime Belegu kandidate për kryetare në Komunën e Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Epoka e Hyjneshës, e paraqitur kundër KQZ, ku ka pretenduar se është larguar nga lista bartëse e këtij subjekti dhe është emëruar Kimete Ahmeti, është parashtruar pas afatit të përcaktuar ligjor.

Bazuar në nenin 29 paragrafi 1 i LQP-së Nr.08/L-228 i cili parasheh që *“Subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së njoftim me shkrim me të cilin shprehet qartazi qëllimin për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për zgjedhje, të përcaktuar sipas nenit 25 paragrafi 1 të këtij ligji”*. Ndërsa në nenin 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parashihet se: *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”*.

Në rastin konkret Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën në PZAP me datë 20.10.2025, ku ka pretenduar se është larguar nga lista bartëse e këtij subjekti dhe është emëruar Kimete Ahmeti, ndërsa nga të dhënat zyrtare, e po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ është vërtetuar se shorti për renditjen e subjekteve politike në fletëvotim për zgjedhjet lokale të datës 12.10.2025 ka përfunduar me datën 04.09.2025, me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor, andaj dhe e njëjta u deshtë që të hedhet si e pasafatshme.

Paneli pas analizimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 9, paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, afati për dorëzimin e ankesës është brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit, ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 24.10.2025, ndërsa parregullsia për të cilin pretendon pala ankuese është bërë gjatë fazës së certifikimit të kandidatëve dhe renditjes së subjekteve politike, e cila ka përfunduar më datë 04.09.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nën 29 paragraf 1, të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nën 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullores 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosi së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL.Anr.339/2025 më datën 27.10.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nën 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.